



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

**PROJEKTVENDIM**

Nr 8472, Datë 26. 05 . 2026

**PËR MIRATIMIN E PBA-së 2027-2029 TË BASHKISË LEZHË PËR FAZËN E PARË.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”; Kryetari i Bashkisë, i paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë Lezhë;

**Për të vendosur:**

- 1.Miratimin e PBA-së 2027-2029 të Bashkisë Lezhë për fazë e parë, sipas projektdokumentit të PBA-së 2027-2029 dhe tabelave përkatës, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 8472/Prot

Lezhë, më 26. 05 .2026

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR MIRATIMIN E PBA-së 2027-2029  
PËR FAZËN E PARË

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”; nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është përgatitur Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm për fazën e parë, dokument i cili është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Në dokumentin e paraqitur, bashkëlidhur projektaktit është relacioni shpjegues për standardet, procedurën, afatet e ndjekura në përgatitjen e PBA-së 2027-2029, për fazën e parë.

Por, në mënyrë të përmbledhur në këtë relacion po ju paraqesim të dhënat kryesore ekonomiko-financiare, si të ardhurat, shpenzimet dhe prioritetet e investimeve që do të realizohen gjatë viteve 2027-2029.

Më konkretisht të dhënat bazë janë:

Të ardhurat gjithsej sipas burimeve:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	2026		2027	Në % / 2026	2028	Në % / 2027	2029	Në % / 2028
		Plani	Rishikuar	Plani		Plani		Plani	
1	Të ardhurat vendore	1,444,869	1,444,869	1,508,972	104.4	1,561,421	103.5	1,576,951	101.0
a	Taksat vendore	955,500	955,500	1,012,000	105.9	1,049,000	103.7	1,059,995	101.0
b	Tarifat vendore	315,000	315,000	322,603	102.4	337,552	104.6	340,844	101.0
c	Të ardhura tjera	174,369	174,369	174,369	0.0	174,369	0.0	176,112	101.0
2	Taksat e ndara	90,500	90,500	97,500	107.7	105,500	108.2	106,555	101.0
3	Transf. Pakushtëzuar	610,662	610,662	638,396	104.5	668,802	104.8	699,398	104.6
4	Transferta Sektoriale	358,815	358,815	365,991	102.0	365,991	0.0	369,651	101.0
5	Grante të huaja	0	3,222	0	0.0	0	0.0	0	0.0
6	Të Trashëguara	0	580,554	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI		2,504,846	3,088,622	2,610,859	104.2	2,701,714	103.5	2,752,555	101.9

Referuar burimeve të mësipërme për vitin 2027 të ardhurat e veta janë 1,508,972 mijë lekë dhe

zënë 57.8% të burimeve gjithsej, të ardhurat nga taksat e ndara janë 97,500 mijë dhe zënë 3.7% e burimeve gjithsej, Transferta e Pakushtëzuar është 638,396 mijë lekë dhe zënë 24.5% të burimeve gjithsej, ndërsa Transferta Sektoriale është 365,991 mijë lekë dhe zënë 14.0% të burimeve gjithsej.

Për vitin 2028 të ardhurat e veta janë 1,561,421 mijë lekë dhe zënë 57.8% të burimeve gjithsej, të ardhurat nga taksat e ndara janë 105,500 mijë dhe zënë 3.9% e burimeve gjithsej, Transferta e Pakushtëzuar është 668,802 mijë lekë dhe zënë 24.8% të burimeve gjithsej, ndërsa Transferta Sektoriale është 365,991 mijë lekë dhe zënë 13.5% të burimeve gjithsej.

Për vitin 2029 të ardhurat e veta janë 1,576,951 mijë lekë dhe zënë 57.3% të burimeve gjithsej, të ardhurat nga taksat e ndara janë 106,555 mijë dhe zënë 3.9% e burimeve gjithsej, Transferta e Pakushtëzuar është 699,398 mijë lekë dhe zënë 25.4% të burimeve gjithsej, ndërsa Transferta Sektoriale është 369,651 mijë lekë dhe zënë 13.4% të burimeve gjithsej.

Të ardhurat nga burimet e veta pësojnë këto ndryshime sipas viteve, konkretisht: në vitin 2027-ato rriten 4.4% në krahasim me vitin 2026, në vitin 2028 rriten 3.5% në krahasim me vitin 2027 dhe në vitin 2029 rriten 1% në krahasim me vitin 2028.

Referuar tabelës mësipër rezulton se për vitin 2027 të ardhurat nga taksat vendore rriten 5.9% në krahasim me vitin 2026, në vitin 2028 rriten 3.7% në krahasim me vitin 2027 dhe në vitin 2029 rriten 1% në krahasim me vitin 2028.

Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2027 pësojnë rritje 2.4% në krahasim me vitin 2026, në vitin 2028 rriten 4.6 % në krahasim me vitin 2027 dhe në vitin 2029 rriten 1% në krahasim me vitin 2028.

Të ardhurat e tjera jo tatimore për vitet 2027 dhe 2028 janë të njëjta me vitin 2026 dhe pësojnë rritje vetëm në vitin 2029, respektivisht 1%.

#### Shpenzimet sipas programeve buxhetore (në mijë lekë):

Nr	Programet buxhetore	K.Prog.	2024	2025	2026		2027	2028	2029
			Fakti	Fakti	Plani	Rishikuar	Plani	Plani	Plani
P.1	Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale	AA127	237,980	327,325	317,218	329,328	324,418	337,097	330,693
P.2	Rendi dhe Siguria Publike	AB127	79,826	125,043	144,962	198,932	117,453	119,810	122,177
P.3	Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	AC127	103,122	123,746	177,425	251,757	154,771	156,613	188,237
P.4	Infrastruktura, Mjedisi, Transporti dhe Shërbimet Publike	AD127	840,512	684,943	1,265,010	1,523,509	1,396,370	1,155,036	1,313,296
P.5	Turizmi dhe Kultura	AE127	69,075	75,717	72,160	77,835	72,521	73,050	73,540
P.6	Arsimi, Rinia dhe Sporti	AF127	283,217	369,291	408,533	517,885	391,828	395,163	398,040
P.7	Përkujdesja Sociale e Strehimi	AG127	68,393	74,838	103,538	173,376	136,498	446,945	307,572
P.8	Fondi Rezervë e Kontigjencës	AH127	0	0	16,000	16,000	17,000	18,000	19,000
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>			<b>1,682,125</b>	<b>1,780,903</b>	<b>2,504,846</b>	<b>3,088,622</b>	<b>2,610,859</b>	<b>2,701,714</b>	<b>2,752,555</b>

#### Shpenzimet sipas strukturës ekonomike (në mijë lekë):

Emri i Artikullit	Kodi Artik.	2024	2025	2026	2026	2027	2028	2029
		Fakti	Fakti	Plani	Rishikuar	Plani	Plani	Plani
<b>Paga&amp;Sigurime (600-601)</b>		<b>666,947.0</b>	<b>803,244.0</b>	<b>965,384.0</b>	<b>1,057,138.0</b>	<b>1,019,073.0</b>	<b>1,029,290.0</b>	<b>1,039,585.0</b>
Paga & Tjera Personeli	600	571,777.0	688,712.0	827,557.0	906,645.0	873,238.0	881,806.0	890,824.0
Sig.Shoqërore/Shëndetësore	601	95,170.0	114,532.0	137,827.0	150,493.0	145,835.0	147,484.0	148,761.0
<b>Shpenzime Korrente të tjera (602-609, 161, 651)</b>		<b>425,267.0</b>	<b>508,443.0</b>	<b>631,876.0</b>	<b>683,550.0</b>	<b>593,901.0</b>	<b>597,424.0</b>	<b>600,421.0</b>
Mallra dhe Shërbime	602	348,096.0	409,877.0	479,687.0	488,137.0	467,920.0	469,222.0	467,731.0

Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferata të Brendshme	604	37,476.0	59,314.0	31,220.0	35,085.0	31,220.0	31,220.0	31,020.0
Transferata të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferata për Buxhetin e Familjive & Individividëve	606	39,695.0	39,252.0	104,969.0	144,328.0	77,761.0	78,982.0	82,670.0
Huamarrje afatgjatë	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	16,000.0	16,000.0	17,000.0	18,000.0	19,000.0
<b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>		<b>589,911.0</b>	<b>469,216.0</b>	<b>907,586.0</b>	<b>1,347,934.0</b>	<b>997,885.0</b>	<b>1,075,000.0</b>	<b>1,112,549.0</b>
Aktive të Patrupëzuara	230	8,881.0	10,829.0	15,840.0	29,232.0	0.0	10,000.0	10,000.0
Aktive të Trupëzuara	231	581,030.0	458,387.0	891,746.0	1,318,702.0	997,885.0	1,065,000.0	1,102,549.0
Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të dala huadhënie nën-hua.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>TOTALI</b>		<b>1,682,125.0</b>	<b>1,780,903.0</b>	<b>2,504,846.0</b>	<b>3,088,622.0</b>	<b>2,610,859.0</b>	<b>2,701,714.0</b>	<b>2,752,555.0</b>

Këto shpenzime për vitin 2027 financohen nga të ardhurat e veta në shumën 1,508,972 mijë lekë, nga taksat e ndara në shumën 97,500 lekë, nga transferata e pakushtëzuara në shumën 639,396 mijë lekë dhe nga transferata sektoriale në shumën 365,991 mijë lekë.

Shpenzimet që financohen nga të ardhurat e veta, taksat e ndara dhe transferata e pakushtëzuar janë në shumën 2,244,868 mijë lekë dhe zënë 86% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet që financohen nga transferata sektoriale janë 365,991 mijë lekë dhe zënë 14 % të shpenzimeve gjithsej.

Referuar burimeve të mësipërme rezulton se shpenzimet sipas strukturave ekonomike paraqiten si më poshtë;

- ◆ Për vitin 2027 shpenzimet gjithsej me burim financimi të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar janë 2,244,868 mijë lekë, ku pagat janë 589,586 mijë lekë, të cilat zënë 26.3% të shpenzimeve gjithsej, sigurime shoqërore janë 98,467 mijë lekë, të cilat zënë 4.4% të shpenzimeve gjithsej (paga dhe sigurime zënë 30.7% të shpenzimeve gjithsej), dhe shpenzimet e tjera korrente janë 558,930 mijë lekë, të cilat zënë 24.9% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet për investime janë 997,885 mijë lekë, të cilat zënë 44.4% të shpenzimeve gjithsej.

- ◆ Shpenzimet me burim financimi nga transferata sektoriale janë 365,991 mijë lekë, ku pagat dhe sigurimet shoqërore janë 331,020 mijë lekë, të cilat zënë 90.4% të shpenzimeve gjithsej, ndërsa shpenzimet e tjera korrente janë 34,971 mijë lekë, të cilat zënë 9.6% e shpenzimeve gjithsej.

PRIORITETET E INVESTIMEVE DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR VITET 2027-2029					
IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE KAPITALE	BURIMI I FINANCIMIT (I MUNDSHËM)	VLERA Në mijë lekë	PËRIUDHA E FINANCIMIT		
			2027	2028	2029
Rehabilitim i kanalit dytë ujitës SV17	Bashkia Lezhë	2,591			2,591
Rehabilitim i kanalit dytë ujitës SV18	Bashkia Lezhë	14,170			14,170
Nd.Prita Malore në zonat pyjore,	Bashkia Lezhë	8,337	8,337		
Hartimi i Planit Mbarëshpimit sip.pyjore Mali Kakarriq	Bashkia Lezhë	5,663	5,663		
Pyllëzime Brinjat e Kreshtë Nj.Admin. Ungrej	Bashkia Lezhë	29,013			29,013
Rehabilitim i rrugëve rurale në fshatra dhe lagje	Bashkia Lezhë	1,123,612	493,697	629,915	
Rehabilitim i rrugëve urbane dhe trotuareve	Bashkia Lezhë	145,000	100,000		45,000
Vazhdim ndërtim i varrezave të reja qytetit Lezhë	Bashkia Lezhë	170,788	112,553	58,235	
Rehabilitim i lulishteve në qytetin Lezhë-Shëngjin	Bashkia Lezhë	92,932	42,932		50,000
Ndërtimi i Parkut në lagjen Nënë Tereza	Bashkia Lezhë	51,499	51,499		

Ndërtimi i Pedonales në rrugën Faik Konica	Bashkia Lezhë	62,770	62,770		
Rikualifikim i trotuareve në zonat rurale e urbane	Bashkia Lezhë	100,000			100,000
Ndërtimi i rrugës dytësore në zonën e Kunes	Bashkia Lezhë	210,000			210,000
Ndërtimi i Koridorit të Gjëlbert Lezhë-Shëngjin	Bashkia Lezhë	220,000			220,000
Ndërtimi i Çerdhes në Nj.Administrative Shënkoll	Bashkia Lezhë	200,000			200,000
Sistemim, asfaltim rr. Qafë Pazari-Ura Martenzës	Bashkia Lezhë	64,532	64,532		
Nd.urës ndërlidhja e qytetit Lezhë me hyrjen e qytetit	Bashkia Lezhë	15,000			15,000
Nd. urës që lidh lagjen Xhenjo me rrugën e Tabes	Bashkia Lezhë	5,000			5,000
Nd. i 2 Terminaleve në qytetet Lezhë-Shëngjin	Bashkia Lezhë	200,000			200,000
Ndërtimi i Banesave Sociale	Bashkia Lezhë	339,699		339,699	
Hartim projektesh	Bashkia Lezhë	20,000		10,000	10,000
<b>TOTALI</b>		<b>3,080,606</b>	<b>941,983</b>	<b>1,037,849</b>	<b>1,100,774</b>

Këto janë të dhënat kryesore për PBA-në 2027-2029, ku në mënyrë të detajuar jepen në Projekt-dokumentin dhe tabelat e PBA-së, bashkëlidhur projektvendimit.

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu

